



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 344/8 prot.

Tiranë, më 5.10.2020

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 264, datë 17.6.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Elona Toro
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F i aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 18.9.2020, është njoftuar vendimi nr. 264, datë 17.6.2020, për subjektin e rivlerësimit znj. Elona Toro, gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin e Komisionit brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, unë, Komisioneri Publik Florian Ballhysa, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 264, datë 17.6.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Elona Toro, ushtron detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Apelit Tiranë dhe, në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës dhe nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin, znj. Elona Toro, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria

kritereve, atë të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si ILDKPKI), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si DSIK) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Inspektorati pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim referuar si IKLD), nga të cilat rezulton se:

2.1 **ILDKPKI**, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “*Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin, znj. Elona Toro*¹”, ka referuar se:

- i. *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- ii. *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- iii. *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- iv. *nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- v. *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2 **DSIK**, bazuar në nenin 39, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, znj. Elona Toro, me nr.*** prot., datë ***.11.2017², referon: “*Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Elona Toro*”.

2.3 **KLGGJ**, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt rivlerësimi, ka përcjellë pranë Komisionit raportin për analizimin e aftësive profesionale³.

3. Përfundimet e Komisionit për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

3.1 *Për vlerësimin e pasurisë.* Referuar nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, hetimi administrativ i Komisionit është shtrirë në kontrollin e gjendjes pasurore të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të, saktësinë dhe mjaftueshmërinë e deklarimeve periodike të interesave pasurore krahasuar me atë “Vetting”, ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, të ardhurat, shpenzimet dhe pagimin e detyrimeve financiare, për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. Nga kontrolli financiar-ligjor për pasuritë e paluajtshme, të luajtshme, të ardhurat, shpenzimet dhe likuiditetet, Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Elona Toro, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “a”, të ligjit nr. 84/2016.

3.2 *Për kontrollin e figurës.* Referuar nenit DH, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni pasi ka administruar raportin mbi verifikimin e figurës, i cili konfirmon përshtatshmërinë e subjektit për vijimin e detyrës, informacioneve nga agjencitë ligjzbatuese dhe pasi ka kryer hetimin administrativ për këtë qëllim, ka vlerësuar se nuk janë gjetur elemente që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit.

¹ Raporti me nr. *** prot., datë ***.4.2018, ILDKPKI.

² Deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë ***.12.2019, të KDZH-së.

³ Raport i KLGJ-së, nr. *** prot., datë ***.9.2019, “Për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Elona Toro”.

3.3 *Për vlerësimin e aftësive profesionale.* Referuar nenit E, të aneksit të Kushtetutës, nenit 43/2 dhe 44, të ligjit nr. 84/2016, si dhe kreut II, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, të ndryshuar, Komisioni, pasi ka administruar raportin e përgatitur nga KLD-ja, rekomandimin nga ana e relatorit të çështjes, hetimin dhe vlerësimin e 25 denoncimeve nga publiku, nuk ka konstatuar problematika thelbësore lidhur me vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit dhe subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është *eficient* dhe efektiv në masë të pranueshme dhe konsiderohet “i aftë” në aspektin profesional, referuar nenit 59, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.

4. Vendimi i Komisionit. Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, trupi gjykues i Komisionit ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit, znj. Toro, ka plotësuar së bashku kushtet e parashikuara nga neni 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, duke arritur një nivel të besueshëm vlerësimi për të tria kriteret, e për këto arsye, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a” dhe nenin 59, pika 4, të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur: [...] *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Elona Toro, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Tiranë* [...].

II. Shkaqet e ankimit

5. Në kuptim të nenit 179/b, të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet që kryejnë procesin e rivlerësimit kalimtar (Vetting).

6. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

7. Në krahasim me kompetencat e njohura për Komisionin dhe Kolegjin nga neni Ç, i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48 - 52, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit ta mbështesë vetëm në vlerësimin e akteve dhe provave të administruara gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni.

8. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, në gjendjen që janë aktet, duke vlerësuar nëse vendimmarrja është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe në një vlerësim të drejtë të provave të administruara.

9. Në vështrim të sa më sipër, Komisioneri Publik, pasi shqyrtoi vendimin nr. 264, datë 17.6.2020, vlerëson se përfundimet e arritura nga Komisioni për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Toro, nuk gjejnë mbështetje në prova dhe në ligjin e zbatueshëm, si dhe nuk bazohen në një hetim të gjithanshëm, të plotë dhe shterues për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të.

10. Komisioneri Publik, duke çmuar se ky vendim, objekt ankimi, shfaq mangësi në hetimin administrativ, konstaton se çështjet e konstatuara, në vlerësim të akteve të administruara

përbëjnë shkaqe të mjaftueshme ligjore për t' u paraqitur për shqyrtim, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.

11. Në këto kushte, Komisioneri Publik e vlerëson të nevojshme që brenda juridiksionit rivlerësues/kontrollues të Kolegjit, ky i fundit, në shqyrtim të këtij ankimi, të riçelë hetimin gjyqësor, pasi rezulton se hetimi i Komisionit nuk ka qenë shterues në drejtim të identifikimit të burimeve të ligjshme të krijimit të të ardhurave të ligjshme, të personave të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, të ardhura që kanë shërbyer për krijimin e pasurive mbi të cilat ushtron të drejta subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. Komisioneri Publik vlerëson të nevojshme rishikimin e analizës financiare të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të, për periudhën e deklarimit. Për sa kohë, eventualisht, konfirmimi në detyrë i subjektit të rivlerësimit realizohet pasi është analizuar secili nga kriteret përkatëse, por edhe në një vlerësim të përgjithshëm të procedurave, Kolegji do të mund ta ushtrojë juridiksionin e tij rivlerësues/kontrollues për të tria kriteret e rivlerësimit.

12. Për sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ky ankim i Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 264, datë 17.6.2020, të Komisionit, ushtrohet për të tria kriteret e rivlerësimit.

II. A Analiza e shkaqeve të ankimit

Për vlerësimin e pasurisë

13. Në lidhje me vlerësimin e kriterit të pasurisë, referuar nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 - 33, të ligjit nr. 84/2016, si dhe jurisprudencës së Kolegjit, Komisioneri Publik mban në konsideratë se gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi sipas nenit 179/b, të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit ("Vetting" dhe ato periodike). Në çdo rast, subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.

14. Komisioneri Publik, në vlerësim të kriterit të pasurisë, është bazuar në aktet e administruara dhe rrethanat e çështjes, të cilat, në gjendjen që janë, paraqesin nevojën për riçeljen e hetimit gjyqësor, pasi konstatohet se hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk ka qenë i gjithanshëm, i plotë dhe shterues.

14.1 Nga verifikimi i akteve rezulton se hetimi i Komisionit mbi verifikimin e burimeve të ligjshme të personave të tjerë të lidhur, burimeve që kanë shërbyer për krijimin e pasurive në posedim apo përdorim të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me subjektin, deklaruar: dhënë në formën e huave apo dhurimeve të ndryshme ndër vite, nuk paraqitet i plotë, përkundrajt rrethanave që janë konstatuar.

14.2 Metodologjia e ndjekur nga Komisioni, në rastin konkret, për analizimin e burimeve të ligjshme të personave të tjerë të lidhur, nuk është e qartë dhe nuk gjen mbështetje në jurisprudencën e deritanishme, pasi nga verifikimi i akteve në dosje konstatohet që për të identifikuar mundësinë e personave të tjerë të lidhur për të mbuluar me burime të ligjshme, huat dhe dhurimet ndaj subjektit të rivlerësimit: (i) nuk përpunohet periudha kohore e të ardhurave të marra në analizë me periudhën e shpenzimeve të jetesës; (ii) numri i personave që realizojnë të ardhura të përfshirë në analizë është i ndryshëm nga numri i personave të llogaritur

në shpenzimet jetike, nuk është në përputhje me dokumentet e administruara në dosje; (iii) në shpenzimet e personave të tjerë të lidhur, nuk janë përfshirë të gjitha të dhënat e dala nga hetimi administrativ.

14.3 Në rastet e shumave të deklaruara të dhuruara nga personat e tjerë të lidhur, nuk rezulton të jetë hetuar duke administruar të plota aktet përkatëse me vlerë provuese në lidhje me eventualitetin e konsiderimit të këtyre të ardhurave si të ligjshme, në kuptim të nenit D të aneksit të Kushtetutës.

14.4 Nga aktet e administruara rezulton se në analizën e kryer nga Komisioni nuk rezulton të jenë përfshirë dhe, për rrjedhojë, të jetë arritur në konkluzione të plota për sa i takon të ardhurave dhe disa zërave të shpenzimeve, të tilla që mund të ndikojnë në konstatimin e deklarimit të saktë të subjektit të rivlerësimit për vitet 2012, 2014, 2015 dhe 2016.

14.5 Vlerësimi i këtyre çështjeve, eventualisht, do të ndikonte në vlerësimin e mjaftueshmërisë dhe burimit të ligjshëm të krijimit të pasurive dhe shpenzimeve të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të.

15. Rezulton se subjekti i rivlerësimit, znj. Elona Toro, është subjekt deklarues për herë të parë në vitin 2003 dhe, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, dhe ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, ka dorëzuar në ILDKPKI deklaratat e interesave private periodike për vitet 2003 - 2016 (në vijim DV -20--) dhe në datën 25.1.2017 ka dorëzuar në ILDKPKI deklaratën “Vetting”, sipas shtojcës nr. 2 të ligjit nr. 84/2016.

16. Nga shqyrtimi dhe krahasimi i deklaratave periodike vjetore me deklaratën “Vetting”, referuar nenit 32, pika 5 të ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit D të aneksit të Kushtetutës, për kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimit dhe burimit të ligjshëm të pasurive, rezulton si vijon:

17. **Pasuria nr. 1, “Apartament me sip. 112.7 m²”, ndodhur në Rrugën e ***, Tiranë (në vijim referuar si “Apartament me sip. 112.7 m²”)**

17.1 Në D-Vett., subjekti deklaron: Apartament banimi me nr. pasurie *** ZK. ***, me sip. totale 112,7 m², ndodhur në Rrugën e ***, Tiranë. Vlera 135.000 euro. *Pjesa takuese*: 100% në bashkëpronësi me bashkëshortin. *Burimi i krijimit*: **i)** 5.800.000 lekë përfituar nga kontrata nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.9.2009, e shitjes së apartamentit në rrugën “***.***”, pallati *** , ap. ***, Tiranë; **ii)** 45.000 euro, sipas kontratës së huas nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.7.2008; **iii)** Kredi e marrë nga Banka ***.*** (në vijim referuar si ***), në shumën 5.000.000 lekë, sipas kontratës kredi bankare nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.2.2011; **iv)** 1.980.000 lekë përfituar nga ekzekutimi i vendimit të Gjykatës së rrethit Tiranë nr. ***, datë ***.3.2006.

17.2 Në DV-2009, në faqen nr. 3, ku kërkohet të deklarohen ndryshimet e interesave private, subjekti i rivlerësimit deklaron: **i)** Nga ekzekutimi në datën ***.7.2009 i vendimit nr. ***, datë ***.3.2006, të Gjykatës së rrethit Tiranë, bashkëshorti ***.*** ka përfituar dëmshpërblim në shumën 2.000.000 lekë; **ii)** Me kontratë sipërmarrje datë ***.7.2009, bashkëshorti ***.*** ka porositur një apartament te shoqëria “***” SHPK, me sipërfaqe 130 m², në Rrugën e ***,

Tiranë, me vlerë 135.000 euro, nga të cilat i ka mbetur si detyrim i pashlyer 80.000 euro⁴. Nuk deklarohet burimi i krijimit; iii) Me kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.9.2009, subjekti dhe babai i saj, z. ***.***, kanë shitur apartamentin në rrugën “***.***” në shumën 5.800.000 lekë. Në po të njëjtin formular, në rubrikën “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti i rivlerësimit deklaron: Kontratë huaje nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.7.2008,⁵ me të cilën bashkëshorti, ***.***, i ka marrë hua z. ***.*** shumën 45.000 euro; – I kam marrë babait shumën që ka pasur në *** Bank, 6.000 euro dhe 4.000 USD.

17.3 Në DV-2010, subjekti nuk deklaron asnjë rrethanë të re faktike lidhur me këtë pasuri, përveç shlyerjes së shumës 5.000 euro, si detyrim ndaj një personi fizik.

17.4 Në DV-2011, subjekti, ndër të tjera, deklaron përmbushjen e detyrimeve ndaj shoqërisë “***” ShPK, nëpërmjet Kredi bankare marrë nga ***, në shumën 5.000.000 lekë, me afat deri në datën ***.3.2031.

17.5 Në krahasimin e përmbajtjes së këtyre deklaratave, konstatohet se në D-Vett. subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar si burim të krijimit të pasurisë depozitat e babait të saj, z. ***.***, pranë bankës ***, respektivisht në shumën 6.000 euro dhe 4.000 USD.

17.6 Nga aktet e administruara në dosje rezulton se origjina e posedimit dhe e pronësisë së kësaj pasurie (apartament banimi) fillon me lidhjen e kontratës së sipërmarrjes⁶ në datën ***.7.2009, mes shoqërisë “***” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit, dhe bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. ***.***, në cilësinë e porositësit. Ndërkohë rezulton se titulli i pronësisë mbi këtë apartament ka kaluar te subjekti i rivlerësimit dhe te bashkëshorti i saj nëpërmjet kontratës së shitblerjes së pasurisë së paluajtshme, me nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.9.2012, lidhur mes tyre dhe shoqërisë “***” ShPK, në cilësinë e shitësit për një çmim prej 135.000 euro.

17.7 Sa më lart, referuar korrespondencës⁷ së Komisionit me ZVRPP-në Tiranë, konstatohet se rezulton e provuar se subjekti i rivlerësimit, znj. Elona Toro, në cilësinë e bashkëshpronares me bashkëshortin e saj, ka të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme, pasurinë e llojit apartament me sip. 112.7 m², me nr. ***, vol. ***, faqe ***, ZK. ***, Tiranë.

18. Mbi mënyrën e pagesës së kësteve të çmimit të blerjes së apartamentit dhe kohën e kryerjes së tyre, subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, dërguar Komisionit, ka deklaruar se ky apartament është shlyer si vijon:

18.1 Kësti i parë, në shumën 12.000 euro, është paguar në datën ***.7.2009, me burim: **i)** 6.000 euro dhe 4.000 USD të tërhequra nga llogaria e babait; **ii)** 3.200 euro nga kësti i parë në shumën 10.000 euro, nga huaja e marrë *cash* nga ***.*** (nuk rezulton në DV-2009).

⁴ Bazuar në aktet në dosje, pagesat për apartament janë kryer në vitet 2008, 2009 dhe 2010, dhe deklarimi i subjektit në DV-2009, se ka mbetur për t'u shlyer 80.000 euro, nuk është i saktë dhe nuk përputhet me aktet në dosje.

⁵ Gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit deklaron se kontrata është nënshkruar në datën ***.7.2009, por është një lapsus i noterit, duke sjellë si provë edhe kopje të regjistrin noterial të vitit 2009.

⁶ Modalitetet e pagesës përcaktuar në nenin 3 të kësaj kontrate: (i) 12.000 euro janë paguar me nënshkrimin e kontratës; (ii) 40.000 euro do të paguhen deri në datën ***.10.2009; (iii) 50.000 euro do të paguhen deri në datën ***.3.2010; (iv) 33.000 euro do të paguhen deri në datën ***.12.2010.

⁷ Shkresa nr. *** prot., datë ***.2.2019, e ZVRPP-së Tiranë.

18.2 Kësti i dytë, në shumën 40.000 euro, është paguar në datën ****.11.2009*, me burim: **i)** 39.200 euro⁸ përfituar me kontratën e shitblerjes nr. **** rep., nr. *** kol., datë ***.9.2009*, në bashkëpronësi të subjektit dhe të babait të saj, z. ****.****; **ii)** 790 euro nga të ardhurat tona.

18.3 Kësti i tretë, në shumën 50.000 euro, është paguar në datën ****.3.2010*, me burim: **i)** 32.500 euro, pjesë e këstit të dytë të kontratës së huas me z. ****.****; **ii)** 2.500 të dhëna *cash* nga z. ****.****, si pjesa e dytë e këstit të dytë të kontratës së huas; **iii)** 1.947.089 lekë nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor për zgjidhjen e pajustificuar të marrëdhënies së punës së bashkëshortit; **iv)** 150.661 lekë nga mbylljet e llogarive të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortit të saj.

18.4 Kësti i katërt dhe i fundit, në shumën 33.000 euro, është paguar në datën ****.5.2011*, me shumën 5.000.000 lekë nga kredia e marrë pranë ****-së*.

18.5 Sa më sipër, deklaratimet e subjektit konfirmohen nga lëvizjet e llogarive bankare të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortit të saj.

18.6 Në vijim të këtij ankimi do të analizohet nevoja e hetimit të mëtejshëm, që lidhet me verifikimin e të ardhurave të ligjshme sipas burimeve të deklaruara:

19. Lidhur me burimin, 6.000 euro dhe 4.000 USD të tërhequra nga llogaria e babait, *.*****

19.1 Ky burim është deklaruar në DV-2009. Konstatohet se, referuar nenit 3, pika 14, nenit 32, pika 4, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni e ka kualifikuar babain e subjektit të rivlerësimit “*person tjetër të lidhur*”, që mbart detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të këtyre depozitave bankare (f. 28-29 të vendimit).

19.2 Nga verifikimi i akteve në dosje, të dhënave të llogarive bankare të babait të subjektit⁹, rezulton se për krijimin e depozitave janë kryer veprimet e mëposhtme nga babai i subjektit:

- Datë ****.9.2007*, ka depozituar shumën 1.900 USD, me afat maturimi 1-vjeçar (riinvestuar në datën ****.9.2008*);
- Datë ****.9.2007*, ka depozituar shumën 4.000 euro, me afat maturimi 1-vjeçar¹⁰;
- Datë ****.11.2008*, ka depozituar shumën 2.000 USD, me afat maturimi 1-vjeçar;
- Datë ****.11.2008*, ka depozituar shumën 270.000 lekë, me afat maturimi 1-vjeçar;
- Këto depozita janë tërhequr në *cash* në datën ****.7.2009*.

19.3 Komisioni, për këtë qëllim, ka kryer analizën financiare për personin tjetër të lidhur për periudhën **deri në korrik 2009**, dhe ka konstatuar pamjaftueshmëri të të ardhurave të ligjshme të babait të subjektit të rivlerësimit për mbulimin e kursimeve dhe shpenzimeve deri në këtë periudhë, në shumën negative – 804.829 lekë, fakt për të cilën i ka kaluar subjektit barrën e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

19.4 Konstatohet se Komisioni, në analizën financiare të pasqyruar në vendimin e arsyetuar, ka përfshirë në të ardhurat e prindërve të subjektit të rivlerësimit, të ardhurat e dokumentuara dhe që plotësojnë kushtin e nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, për periudhën 1991- korrik

⁸ Shuma nga shitja e apartamentit ishte 5.800.000 lekë, nga të cilat 5.418.944 lekë është vlera e mbetur pas pagesës së tatimit mbi të ardhurat, e cila, pas përfitimit të interesave bankare, e konvertuar në euro, është 39.210 euro.

⁹ **** Bank*, me shkresë nr. *****, datë ****.9.2019*, si dhe dokumentacion bankar, të paraqitur si provë nga vetë subjekti i rivlerësimit, bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2.

¹⁰ Tërhequr pjesërisht në datën ****.7.2008* dhe ridepozituar në datën ****.11.2008*.

2009, ndërkohë në shpenzimet e jetesës janë llogaritur shpenzimet për 1 person, sipas INSTAT-it, për periudhën 2001 - 31.7.2009.

19.5 Pas shpjegimeve përfundimtare të subjektit, datë 6.6.2020, dhe provave të depozituara, Komisioni ka arritur në përfundimin se: [...] *Referuar analizës së kryer dhe vlerësimit të të gjitha rrethanave dhe fakteve të pasqyruara si më sipër, bazuar në parimet e objektivitetit dhe proporcionalitetit, si dhe në mungesë të indicieve të besueshme për fshehje pasurie të subjektit të rivlerësimit, Komisioni krijoi bindjen se personi tjetër i lidhur (babai i subjektit të rivlerësimit) ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht krijimin e shumave 6,000 euro dhe 4,000 USD, të dhëna në favor të subjektit, me qëllim kryerjen e pagesës së këstit të parë për blerjen e apartamentit objekt hetimi [...].¹¹*

19.6 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, konkluzioni sa më sipër nuk përputhet me aktet në dosje. Metodologjia e ndjekur nga Komisioni për të analizuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të personit tjetër të lidhur, z. ***,***, mbi llogaritjen e shpenzimeve të jetesës sipas standardit të INSTAT-it, vetëm për 1 person dhe për një periudhë kohore të ndryshme (më të shkurtër në rastin në fjalë) sesa periudha për të cilën llogariten të ardhurat e gjithë pjesëtarëve të familjes, sipas përbërjes familjare ndër vite, nuk mbështetet në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit apo në vetë vendimet e Komisionit.

19.7 Paqartësitë e kësaj metodologjie të ndjekur në rastin në fjalë për kryerjen e analizës financiare dhe rezultatet e arritura për shkak të saj, si për sa i takon: (i) periudhës në të cilën shtrihet kjo analizë, (ii) burimeve të të ardhurave të përfshira, (iii) investimeve të kryera dhe (iv) mundësisë së kursimit, nuk kanë bërë të mundur argumentimin e situatave juridike të vërtetuara, të cilat kanë nevojë të verifikohen dhe mbi to të arrihen përfundime, bazuar në dispozitat e ligjit nr. 84/2016.

19.8 Për këtë arsye, analiza financiare e personit tjetër të lidhur, z. ***,*** për shumat e dhuruara 6.000 euro dhe 4.000 USD, do të duhej të ishte kryer për periudhën shkurt 2005¹² – nëntor 2008 (sipas datave të depozitimit të kursimeve në llogaritë bankare), duke i kaluar subjektit të rivlerësimit eventualisht barrën e provës në lidhje me burimet e ligjshme për krijimin e të ardhurave të ligjshme, që kanë shërbyer për krijimin e dy depozitave të personit tjetër të lidhur, e që janë përdorur si një ndër burimet për pagesën e çmimit të pasurisë: *apartament banimi*.

20. Lidhur me burimin e huas 45.000 euro, marrë nga z. *,*** (deklaruar 10.000 euro marrë cash në vitin 2009, nga të cilat përdorur këtë vit vetëm 3.200 euro¹³)**

20.1 Nga aktet në dosje, rezulton e administruar kontrata noteriale e huas nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***,7.2008, nënshkruar ndërmjet shtetasve: z. ***,***, në cilësinë e huadhënësit

¹¹ Shih faqen 30 të vendimit të KPK-së.

¹² Rezulton se në periudhën tetor 2004 – janar 2005 ka kryer investime në pasuri të paluajtshme: apartament banimi, me sipërfaqe 78 m², me vlerë 51.000 euro, ndodhur në rrugën “****.***”, Tiranë, transaksion i finalizuar me kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***,4.2013, në vlerën 51.000 euro (paguar deri në janar 2005 shuma 46.000 euro), për blerjen e të cilit ka marrë hua si nga e bija, subjekti i rivlerësimit (sipas deklaramit të saj në DV-2005) dhe nga shtetasi ***,***, sipas deklarimeve të subjektit gjatë hetimit administrativ.

¹³ Në DV-2009, subjekti nuk ka deklaruar si pagesë për blerjen e pasurisë nr.1, përdorimin e shumës 3.200 euro, pjesë e huas së marrë nga z. ***,***, dhe mbetjen e shumës prej 6.800 euro në këtë vit, ndërkohë që këtë fakt e ka deklaruar vetëm gjatë hetimit administrativ.

dhe bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e huamarrësit, për shumën 45.000 euro, hua e dhënë me 3% interes vjetor.

20.2 Gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kjo shumë është marrë me disa këste, respektivisht: (i) 10.000 euro marrë në vitin 2009 (*nga të cilat përdorur për pagesën e këstit të parë të apartamentit vetëm shuma prej 3.200 euro, pjesa tjetër mbetur në banesë*), (ii) shuma 4.500.000 lekë transferuar nga shtetasi z. ***.*** nëpërmjet llogarisë bankare në datën ***.3.2010¹⁴; (iii) shuma 2.500 euro dhënë *cash* në vitin 2010, për të plotësuar shumën prej 45.000 euro të dakordësuar.

20.3 Komisioni, referuar nenit 3, pika 14, nenit 32, pika 4, të ligjit nr. 84/2016, e ka konsideruar shtetasin z. ***.*** si person tjetër të lidhur dhe i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të dokumentojë burimin e ligjshëm të të ardhurave të këtij shtetasi.

20.4 Subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ, ka deklaruar se: [...] *shtetasi ***.*** ka ushtruar prej vitesh aktivitet, dhe burimi i të ardhurave të dhëna hua rrjedh nga të ardhurat nga aktiviteti i z. ***.***, nga të ardhurat nga shitja e pasurive në pronësi të babait, z. ***.***, të ardhura të cilat janë administruar nga huadhënësi, z. ***.***, të ardhura nga pjesëmarrjet në aksionet e disa shoqërive aksionare, të ardhura nga interesat bankare etj.[...].*

20.5 Për të vërtetuar sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacion justifikues në lidhje me burimet e të ardhurave të personit tjetër të lidhur¹⁵, si dhe ka pretenduar faktin se huadhënësi, shtetasi ***.***, gjatë periudhës deri në momentin e dhënies së huas nuk rezultojn të ketë investuar në pasuri të paluajtshme apo të luajtshme (automjete). Subjekti i rivlerësimit ka parashtruar po ashtu se: [...] *për administrimin e pasurive të luajtshme të z. ***.***, nga i biri i tij (në të gjallë të tij), z. ***.***, i ka pohuar se mes tyre nuk ka pasur ndonjë akt të posaçëm për të rregulluar këtë marrëdhënie. Kjo në radhë të parë për lidhjen mes tyre si babë e bir, por edhe si rrjedhojë e traditës shqiptare, pasi, si djalë i vetëm, që jetonte me prindërit, marrëdhënia e besimit mes tyre nuk vihej në dyshim. Ky fakt konstatohet lehtësisht edhe në rastin e llogarisë dyemërore të bonove të thesarit në Bankën e Shqipërisë, ku *** dhe *** kishin të njëjtën llogari, pa përcaktuar pjesët e secilit. Një mënyrë e tillë menaxhimi të pasurive përbënte lehtësim për familjen e tyre, kjo edhe për shkak të moshës që kishte z. ***.***, i lindur në vitin 1926 [...].*

20.6 Lidhur me këtë fakt, Komisioni ka arsyetuar¹⁶ se: [...] *që prej vitit 2002 huadhënësi, z. ***.***, dhe babai i tij, z. ***.***, kanë pasur llogari dyemërore në investime për bono thesari në Bankën e Shqipërisë, të cilat janë në vlera të konsiderueshme. Nga analizimi në tërësi i të dhënave dhe provave të evidentuara si më sipër, ... Komisioni çmon se duken bindëse shpjegimet e dhëna lidhur me administrimin e pasurisë së familjes ***.***, nga djali i tyre, huadhënësi z. ***.***, dhe se nuk ka dyshime për dhënien e pëlqimit nga familjarët e tij për kalimin e shumës prej 45,000 euro, si hua në favor të z. ***.***. Në këtë këndvështrim, si dhe në vlerësim të faktit se huadhënësi, z. ***.***, ka qenë në të njëjtin trung familjar me babanë*

¹⁴ Ky transaksion konfirmohet dhe nga *** me shkresën nr. *** prot., datë ***.2.2019.

¹⁵ Deklaratë noteriale nr. ***, datë ***.10.2019, kontrata shitje pasuri të paluajtshme, ku njëri nga shitësit rezultojn ***.***, me pjesë takuese 1/2 e 1/3 për vitet 1998-2006; kontratë shitje e apartamentit në Shkodër në bashkëpronësi të huadhënësit ***.*** dhe të dy prindërve të tij, ***.*** dhe ***.***, dokumente nga organet tatimore mbi të ardhurat/xhirot për periudhën 1994-2008; të dhëna nga QKB mbi pjesëmarrjet në shoqëritë aksionare të ***.*** dhe ***.***; dokumente nga ISSH-ja mbi masën e pensionit të prindërve ***.*** dhe ***.***, dokumente nga institucionet mbi të ardhurat e përfituara të shtetasit ***.*** nga statusi i veteranit.

¹⁶ F. 16 e vendimit të Komisionit.

*e tij (deri në vitin 2011, kur ka ndërruar jetë), Komisioni arrin në përfundimin se të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurive të paluajtshme të z. ***.***, të evidentuara me kontrata noteriale shitjeje, përfshirë edhe të ardhura të tjera të evidentuara me dokumentacion justifikues ligjor, do të pasqyrohen në analizën financiare të huadhënësit si të ardhura që kanë shërbyer për krijimin e shumës prej 45,000 euro, të dhënë hua në favor të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit [...].*

20.7 Pas administrimit të dokumentacionit dhe shpjegimeve të subjektit, Komisioni ka kryer analizën financiare të personit tjetër të lidhur, z. ***.***, për periudhën e viteve 1994-2009. Në të ardhurat e shtetasit z. ***.*** konstatohet të jenë përfshirë: (i) të ardhurat e realizuara nga aktiviteti tregtar i z. ***.***, të vlerësuara në masën 20% të totalit të qarkullimit vjetor (ose të maksimumit të fashës për vitet kur ky shtetas ka paguar tatim sipas fashave); (ii) të ardhurat nga paga për periudhën 2005 - 2009; (iii) të ardhurat nga interesat bankare për depozitat dhe bonot e thesarit në pronësi të shtetasit ***.*** dhe ***.***; (iv) të ardhurat nga pjesa takuese nga shitja e pasurive në emër të babait, z. ***.***; (v) të ardhurat e përfituara nga statusi i veteranit të këtij të fundit, si dhe të ardhurat nga pjesëmarrja në shoqëritë aksionare të z. ***.*** dhe z. ***.***. Ndërkohë që konstatohet se në analizën financiare të Komisionit, si shpenzime janë llogaritur vetëm shpenzime jetese për periudhën e viteve 2000-2009, vetëm për 1 person, shtetasin ***.***, sipas të dhënave të INSTAT-it, si dhe huaja dhënë subjektit, e konvertuar në monedhën lekë.

20.8 Lidhur me këtë metodologji të përdorur për kryerjen e analizës financiare të mësipërme, Komisioni, duke iu referuar parimit të proporcionalitetit, ka arsyetuar se: [...] *personi tjetër i lidhur, z. ***.***, ka pasur burime financiare të ligjshme për të mundësuar plotësisht dhënien e huas në favor të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit¹⁷. Në analizë të të gjitha provave të depozituara dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit duket qartë që huadhënësi, z. ***.***, dhe familja e tij kanë pasur një situatë të shëndetshme financiare – kjo si rrjedhojë e aktivitetit tregtar të huadhënësit, aksioneve që zotëronte huadhënësi dhe babai i tij në shoqëri të ndryshme tregtare, të ardhurat e përfituara nga z. ***.***, si ish-i përndjekur politik, si dhe me burim shitjen dhe dhënien me qira të pasurive të paluajtshme, në të cilat zotëronin pjesë takuese babai dhe nëna e huadhënësit[...]. Në këtë kuptim, në analizën financiare janë evidentuar vetëm të ardhurat e familjes ***, të deklaruara si burim huaje nga huadhënësi (pa përfshirë pensionet apo të ardhura të tjera të mundshme), për të cilat dokumentohet pagesa e detyrimeve tatimore, duke sjellë në vëmendje faktin se huadhënësi dhe personat e lidhur me të nuk kanë qenë subjekte të deklarimit të pasurive, por edhe faktin se nga momenti i dhënies së huas ka kaluar një periudhë e gjatë kohe dhe mund të mos kenë treguar kujdesin e duhur për ruajtjen e plotë të dokumentacionit për të gjitha të ardhurat e përfituara ndër vite [...].*

20.9 Komisioni, gjithashtu, ka arsyetuar se: [...] *Nga shqyrtimi i të dhënave financiare të mësipërme - të para në një këndvështrim tjetër, duket se vetëm të ardhurat e z. ***.***, të përlllogaritura nga Komisioni për periudhën deri para dhënies së huas, janë përafërsisht rreth 5,400,000 lekë (pa përfshirë të ardhurat e përfituara prej tij për periudhën janar - mars të vitit 2010), të cilat (duke përfshirë të ardhurat e përfituara për periudhën janar - mars të vitit 2010) janë të mjaftueshme për krijimin e një shume prej rreth 40,000 euro. Bazuar në parimin e proporcionalitetit, në vlerësim të informalitetit të kohës dhe të pretendimeve të huadhënësit për*

¹⁷ F. 19 e vendimit të Komisionit.

*fitimin neto të realizuar nga aktiviteti i tij tregtar, si dhe duke konsideruar se shpenzimet e tij janë mbuluar nga familjarët me të ardhurat nga shitja apo dhënia me qira e pasurive të paluajtshme, duket se ka pasur burime financiare të ligjshme për dhënien e huas në favor të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, të mbuluara me të ardhurat e përfituara prej tij. Si përfundim, trupi gjykues krijoi bindjen e plotë se personi tjetër i lidhur, z. ***.***, ka pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime financiare të ligjshme, për të mundësuar plotësisht dhënien e huas në favor të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit [...].*

21. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, konkluzioni sa më sipër nuk përputhet me aktet në dosje dhe as nuk rrjedh si rezultat i një hetimi të plotë që duhej të ishte kryer nga ana e Komisionit.

21.1 Bazuar në provat shkresore të administruara në dosje, rezulton se sipas certifikatës familjare, lëshuar në datën 18.9.2019, në përbërjen familjare të personit tjetër të lidhur, z. ***.***, rezultojnë 4 persona deri në 1996, 5 persona për periudhën 1996 - 2006 dhe 6 persona 2006 - 2009. Kryefamiljar rezulton shtetasi z. ***.*** deri në datën 5.8.2011.

21.2 Parë në këtë këndvështrim, mbështetur edhe në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit dhe në arsyetimin e vetë Komisionit, në vlerësimin e Komisionerit Publik, ai, Komisioni, duhej të kishte hetuar sipas kësaj situatë faktike, mbi të gjitha zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve, gjatë periudhës deri në vitin 2009.

21.3 Edhe në këtë rast, metodologjia e ndjekur nga Komisioni në vlerësimin e burimit të ligjshëm të krijimit të të ardhurave të ligjshme të personit tjetër të lidhur është e paqartë dhe nuk mbështetet në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit apo dhe të vetë Komisionit. Kështu konstatohet mangësi në lidhje me përcaktimin e: (i) numrit të personave që sigurojnë burimin e të ardhurave të ligjshme; (ii) periudhën e llogaritjes së krijimit të këtyre të ardhurave; (iii) mënyrën e llogaritjes së shpenzimeve të jetesës sipas standardit të INSTAT-it, vetëm për 1 person (*ndërkohë që në zërin “të ardhura” përfshihen si të ardhurat e përfituara nga z. ***.*** dhe ato të përfituara nga z. ***.****).

21.4 Mospërputhja e këtyre elementeve të rëndësishëm të situatës faktike me atë të përfshirë në metodologjinë e kryerjes së analizës financiare nuk bën të mundur verifikimin e qartë të mundësisë financiare të personave të tjerë të lidhur, për të mbuluar me burime të ligjshme shumën e deklaruar dhënë hua.

21.5 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, analiza financiare e personave të tjerë të lidhur do të duhej të ishte kryer duke marrë në konsideratë të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e dokumentuara sipas akteve të administruara, për të gjithë periudhën në fjalë.

21.6 Për sa më sipër, në vlerësimin e Komisionerit Publik, hetimi dhe konkluzionet e Komisionit mbi cilësimin e personave të tjerë të lidhur dhe analiza e burimeve të ligjshme të tyre për të mbuluar shumën e deklaruar dhënë hua, nuk janë të plota dhe shteruese.

22. *Lidhur me burimin: “39.200 euro,¹⁸ përfitur me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.9.2009, në bashkëpronësi të subjektit dhe babait të saj z. ***.***”*

¹⁸ Shuma nga shitja e apartamentit ishte 5.800.000 lekë, nga të cilat 5.418.944 lekë është vlera e mbetur pas pagesës së tatimit mbi të ardhurat, e cila e konvertuar në euro është 39.210 euro.

22.1 Në DV-2009, subjekti deklaroi se me kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.9.2009, subjekti dhe babai i saj, z. ***.***, kanë shitur apartamentin në rrugën “***.***”, në shumën 5.800.000 lekë.

22.2 Komisioni, fillimisht, në rezultatet e hetimit të njoftuara subjektit të rivlerësimit ka konstatuar se:¹⁹[...] *subjekti nuk ka deklaruar mënyrën e përfitimit të vlerës prej 1/2 nga shitja e apartamentit në bashkëpronësi me babain, përdorur si burim krijimi për pasurinë objekt hetimi, pasi as në deklaratën periodike vjetore dhe as në deklaratën “Vetting” nuk ka deklaruar si dhurim 1/2 e vlerës së shitjes së kësaj pasurie, ligjërisht pjesë takuese e babait të saj. Subjekti ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për burimin e krijimit të pasurisë objekt hetimi [...]. Në vijim, Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit lidhur me këto konstatime.*

22.3 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se²⁰: [...] *Në DV-2009 kam shënuar se shuma prej 5,800,000 lekësh është përfitur nga shitja e apartamentit, në bashkëpronësi me babanë dhe, meqenëse gjysmën ligjore të kësaj shume babai ma dha pa ndonjë kontratë dhurimi apo aktmarrëveshje, nuk e kam shënuar si dhurim [...].*

22.4 Rezulton se në mungesë të një akti noterial apo veprimi bankar për kryerjen e këtij kalimi të drejtash civile nga babai i saj, te subjekti i rivlerësimit, Komisioni, për verifikimin e përmbushjes eventuale të kriterëve ligjore, të parashikuara në nenin D të aneksit të Kushtetutës, është mjaftuar me një pohim të subjektit gjatë seancës dëgjimore të datës 12.6.2020.

22.5 Në vendimin e tij, Komisioni arsyeton se: [...] *Duket se përpara se të merrte shumën e plotë nga shitja e apartamentit në bashkëpronësi me babanë, në vitin 2009 (shuma totale neto 5,418,944 lekë), subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti e kanë ndihmuar financiarisht z. ***.*** ... sipas informacionit bankar dhe deklarimeve të subjektit, në shumën prej 2,020,000 lekësh. Në konsideratë të faktit se 1/2 e vlerës neto, të përfitur nga shitja e apartamentit në vitin 2009 (pas pagesës së tatimit) është 2,709,472 lekë dhe vlera e ndihmës financiare të dhënë në vazhdimësi nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj në favor të z. ***.*** (deri në vitin 2009) për prenotimin e apartamentit në vitin 2005 është në shumën 2,720,000 lekë, duket se me përfitim të shumës së plotë nga shitja e apartamentit në vitin 2009. subjekti është “kompensuar/i janë kthyer shumat” për vlerat e dhëna ndër vite për babanë e saj – kjo në këndvështrim edhe të marrëdhënies së posaçme mes [...].²¹*

22.6 Në vijim, Komisioni edhe pse arsyeton se: [...] *Fakti i përfitimit nga subjekti të shumës së plotë nga shitja e pasurisë në bashkëpronësi me babanë, merr kuptim dhe duhet të jetë pjesë e verifikimeve që kryhen në kuadër të procesit të rivlerësimit, në zbatim të detyrimit kushtetues që ka subjekti i rivlerësimit, sipas parashikimit të pikës 3, të nenit D të aneksit të Kushtetutës, për të provuar burimin e ligjshëm të pasurive [...]²², në përfundim ka konkluduar se: [...] pasaktësitë në deklaram janë pa pasoja dhe, si të tilla, nuk janë mbajtur në konsideratë gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar. Për sa më sipër, në vlerësimin tërësor dhe në harmoni të provave shkresore të administruara në dosje, transaksioneve të kryera, deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit, ndër vite, në ILDKPKI dhe shpjegimeve të dhëna nëpërmjet*

¹⁹ Referohuni rezultateve të hetimit datë 22.5.2020.

²⁰ Referohuni shpjegimeve përfundimtare datë 6.6.2020.

²¹ Shih f. 8, të vendimit të Komisionit.

²² Shih f. 9, të vendimit të Komisionit.

*pyetësorëve/prapësimeve të dërguara në kuadër të hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, trupi gjykues krijoi bindjen se të ardhurat (minus tatimin e paguar) nga shitja e apartamentit në vitin 2009, në bashkëpronësi me babanë, janë përfituar plotësisht nga subjekti i rivlerësimit dhe kanë shërbyer si burim krijimi i pasurisë objekt hetimi [...]*²³.

23. Komisioneri Publik e gjen kontradiktor këtë arsyetim të Komisionit për sa i takon nga njëra anë: (i) verifikimit të ekzistencës së marrëdhënies që ka ekzistuar mes subjektit të rivlerësimit dhe babait të saj në shlyerjen ndër vite nga ana e subjektit të rivlerësimit të një detyrimi financiar të z. ***.***, pra të kompensimit të një marrëdhënie të mëparshme interesi dhe, nga ana tjetër: (ii) e kalimit të gjithë shumës së shitjes së apartamentit në bashkëpronësi me babait të saj dhe subjektit të rivlerësimit në vitin 2009, në favor të subjektit të rivlerësimit.

23.1 Në rastin e pretendimit nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe verifikimit të një marrëdhënie kompensimi të një detyrimi financiar, që ka ekzistuar mes babait të subjektit të rivlerësimit dhe vetë znj. E. Toro, përpara shitjes së apartamentit në bashkëpronësi në vitin 2009, kjo marrëdhënie juridike civile nga Komisioni duhej të argumentohej e tillë që të ndikonte në vlerën totale të të ardhurave, të cilat përbëjnë diferencën mes: (i) vlerës së paguar nga subjekti i rivlerësimit në favor të personit të lidhur, për një detyrim të këtij të fundit dhe (ii) asaj të kaluar nga personi i lidhur te subjekti i rivlerësimit, pas shitjes së apartamentit në bashkëpronësi, diferencë e cila, për shkak se do të duhej të konsiderohej si dhurim, duhej t'i nënshtrohej eventualisht edhe dispozitave të legjislacionit përkatës tatimor.

23.2 Në përfundim, për këtë pasuri, në vlerësimin e Komisionerit Publik, hetimi i kryer nga Komisioni nuk ka qenë i plotë në drejtim të: (i) përcaktimit të drejtë të personave të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit; (ii) përcaktimit të drejtë të metodologjisë së përdorur për të kryer analizën financiare të personave të tjerë të lidhur, e cila, për sa gjendet e dokumentuar në fashikullin përkatës, nuk është në përputhje me jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit.

24. *Pasuria nr. 2, “Vend parkimi makine (garazh)”, ndodhur në Rruga e ***, Tiranë (në vijim referuar si “garazhi”)*

24.1 Në D-Vett., subjekti i rivlerësimit deklaroi: *Vend parkimi makine (garazh)*, ndodhur në Rruga e ***, Tiranë. Vlera 12.000 euro. *Burimi i krijimit: i)* 10.000 euro kontribut nga babai i bashkëshortit tim, pa dokument, për shkak të lidhjes së posaçme; *ii)* 2.000 euro e shlyer nga ne. *Pjesa takuese: 100% në bashkëpronësi me bashkëshortin, z. ***.***.*

24.2 Në DV-2011, subjekti i rivlerësimit deklaroi: *Blerje vend parkimi*, në shumën 12.000 euro. *Burimi: 10.000 euro janë dhënë nga babai i bashkëshortit (vjehtëri) në dy pjesë, pa dokument. 2.000 euro detyrim i mbetur ndaj shoqërisë “****” ShPK., në lidhje me vendparkimin.*

25. Lidhur me burimin e deklaruar si “dhurim” nga babai i bashkëshortit, në vlerësimin e Komisionerit Publik, hetimi i Komisionit nuk ka qenë i plotë, në kuptim të verifikimit të burimit të ligjshëm të të ardhurave të ligjshme të prindërve të bashkëshortit të subjektit. Nga aktet në dosje ka rezultuar se:

25.1 Referuar deklarimeve periodike të subjektit të rivlerësimit, si dhe shpjegimeve të dhëna gjatë hetimit administrativ, rezultoi se babai i bashkëshortit, z. ***.***, i ka dhuruar subjektit

²³ Shih f. 9, të vendimit të Komisionit.

të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, ***.***, shuma të ndryshme ndër vite, në total rreth 3.357.960 lekë, në periudhën mes viteve 2010 - 2016.

25.2 Komisioni, referuar nenit 3, pika 14, nenit 32, pika 4, të ligjit nr. 84/2016, ka cilësuar prindërit e bashkëshortit të subjektit si persona të tjerë të lidhur dhe i ka kërkuar subjektit shpjegime lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të tyre.

25.3 Subjekti i rivlerësimit, pasi ka paraqitur dokumentacionin përkatës, ka parashtruar se: [...] në vitin 1992 nga Bashkia Tiranë, familjes Toro iu kthye një nga vilat më me vlerë në Tiranë (bashkëpronar i së cilës ishte edhe babai i bashkëshortit të subjektit). Që nga ky vit e në vijim, deri në shitjen e saj, familja Toro ka pasur marrëdhënie qiraje në vlerën rreth 5,000 USD/muaj... Në datën ***.12.2001, familja Toro shiti pasurinë vilë + truall, të ndodhur në rr. "****.***", në vlerën 500,000 USD, për të cilën është paguar edhe tatimi mbi kalimin e pronësisë në vlerën rreth 15,000 USD [...]. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar: [...] se në datën ***.3.2009 ka ndërruar jetë halla e bashkëshortit, znj. ***.***, e cila ka qenë beqare dhe pa fëmijë. Si trashëgimtar ligjor ishte edhe i ndjeri, z. ***.***, në ¼ pjesë të pasurisë së saj. Sikundër pasuria e krijuar nga prona e sipërcituar, e dhënë me qira e më pas e shitur dhe halla e bashkëshortit të subjektit gëzonte pjesën e saj në këtë pasuri. Këto të ardhura dhe kursimet e saj ndër vite, i krijuan babait të bashkëshortit të subjektit edhe një kreditim tjetër të pasurisë së tij. Burim tjetër i të ardhurave të babait të bashkëshortit të subjektit janë pensionet e pleqërisë, bonot e thesarit, dëmshpërblimi si i përndjekur politik [...].

25.4 Në vendimin e tij konstatohet se Komisioni arsyeton se: [...] Meqenëse Komisioni i ka kërkuar subjektit të shpjegojë dhe të provojë me dokumentacion justifikues ligjor burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për çdo shumë të dhuruar nga z. ***.***, analiza financiare dhe verifikimi i ligjshmërisë së burimit të krijimit për të ardhurat e tij është kryer njëherësh për totalin e shumave të dhuruara [...].

25.5 Pavarësisht se pretendohet nga Komisioni të jetë kryer një analizë financiare, për sa kohë prindërit e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit janë cilësuar si persona të tjerë të lidhur, nga aktet në fashikullin përkatës rezulton se kjo analizë financiare mungon.

25.6 Në këtë gjendje të akteve rezulton se Komisioni në vendimin e tij konkludon se: [...] është fakt se referuar të dhënave nga ***-ja rezulton se në llogarinë e përbashkët në dollarë, të shtetasve *** dhe ***.***. (prindërit e bashkëshortit të subjektit), në datën ***.9.2002, kanë qenë të depozituara në depozitë me afat shumat 41,000. USD dhe 80,429 USD. Gjithashtu konstatohet se z. ***.***., babai i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, ka përfituar pension pleqërie, që nga korriku i vitit 1990, në masën aktuale 26,895 lekë/muaj. Për sa më sipër, nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosje, vetëdeklarimeve të subjektit dhe provave të depozituara në Komision në kuadër hetimit administrativ, trupi gjykues vlerëson se z. ***.***, ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar shumat e dhuruara ndër vite, për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të [...].

25.7 Mungesa e kryerjes së një analizë financiare nga ana e Komisionit gjatë hetimit administrativ, për personat e tjerë të lidhur z. *** dhe znj. ***.*** ka pamundësuar verifikimin dhe, për pasojë, edhe mundësinë e subjektit që të japë shpjegimet përkatëse për situata faktike, që duket se gjenden të provuara nga aktet e administruara në fashikullin përkatës të Komisionit.

25.8 Në kryerjen e kësaj analize financiare për personat e tjerë të lidhur të subjektit të rivlerësimit, eventualisht duhet të gjejnë trajtim ligjor dhe financiar elemente të tilla që evidentohen nga aktet e administruara, por nuk janë hetuar në mënyrë të plotë nga Komisioni, të tillë si: (i) periudha e depozitimit dhe debitimet e kryera në llogaritë bankare nga personat e tjerë të lidhur gjatë periudhës janar 2003 - gusht 2007 apo (ii) investimet eventuale të kryera nga personat e tjerë të lidhur, z. *** dhe z. ***.***, gjatë periudhës në të cilën janë realizuar dhurimet për familjen e subjektit të rivlerësimit²⁴.

26. Dhurimet e personit tjetër të lidhur z. *.*****

26.1 Nga babai i saj, z. ***.***, subjekti i rivlerësimit në DV nga viti 2008 - 2016, ka deklaruar se ka përfituar dhurime për fëmijët e saj, në shumat si vijon: (i) në vitin 2008: shumën 150.000 lekë²⁵; (ii) në vitin 2010: shumën 150.000 lekë; (iii) në vitin 2012: shumën 200.000 lekë; (iv) në vitin 2013: shumën 100.000 lekë; (v) në vitin 2014: shumën 150.000 lekë dhe në vitin 2016: shumën (vi) 200.000 lekë; gjithsej shuma prej 950.000 lekë.

26.2 Komisioni, sikundër detajuar më lart në këtë ankim, ka cilësuar z. ***.*** si person tjetër të lidhur dhe ka kryer analizën financiare për të provuar mundësinë e z. *** për kryerjen e dhurimeve të tjera në favor të subjektit të rivlerësimit (kreditimi i llogarive bashkëmore me fëmijët e saj), për periudhën 1.8.2009²⁶ – 31.12.2016, në vlerë totale për këtë periudhë prej 800.000 lekësh.

26.3 Më tej, Komisioni ka vlerësuar se: [...] *Referuar analizës financiare konstatohet se personi tjetër i lidhur (babai i subjektit të rivlerësimit) ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht shumat e dhuruara për subjektin e rivlerësimit/nipërit e tij, të deklaruara ndër vite.*

26.4 Rezulton se Komisioni, në kryerjen e analizës financiare për personin tjetër të lidhur z. ***.***, për të provuar mundësinë financiare për të dhuruar shumën 800.000 lekë, për periudhën 2009 - 2016, ka marrë në konsideratë në shpenzimet e tij, shpenzimet e jetesës për këtë periudhë dhe shpenzimin për pagesën e këstit të fundit të apartamentit në vitin 2013.

26.5 Komisioneri Publik, në vlerësimin e kryerjes së analizës financiare të personit tjetër të lidhur, z. ***.***, konstaton se Komisioni nuk ka hetuar dhe, për rrjedhojë, nuk arsyeton në lidhje me zërin “investime”, të kryera nga personi tjetër i lidhur, për depozita bankare të krijuara nga ana e tij në periudhën 2014 - 2016, për një vlerë prej 1.390.198 lekë.

27. Në lidhje me analizën financiare të mbulimit me burime të ligjshme të shpenzimeve dhe kursimeve të subjektit dhe personave të lidhur me të, për periudhën 2003 - 2016

27.1 Bazuar në aktet në dosje, Komisioni ka kryer dhe një analizë financiare në lidhje me verifikimin e mbulimit me burime të ligjshme të shpenzimeve dhe kursimeve të subjektit dhe personave të lidhur me të, për periudhën 2003 - 2016.

²⁴ Referuar shkresës nr. *** prot., datë ***.10.2019, të OSHEE-së, me gjeneralitete ***.***.***, identifikohet një abonent me kontratë furnizimi në instancën Kavajë dhe me gjeneralitete ***.***, identifikohet një abonent në instancën Tiranë (e ndryshme nga ajo e referuar gjatë hetimit), si dhe shkresa nr. *** prot., datë ***.9.2019, UK Tirana sh.a., për një abonent me gjeneralitete ***.***.

²⁵ Përveç shumës së dhuruar për blerjen e apartamentit në vitin 2009.

²⁶ Dhurimet e vitit 2008 janë trajtuar së bashku me mundësinë e personit tjetër të lidhur për të mbuluar me burime të ligjshme dhurimet ndaj subjektit deri në vitin 2009.

27.2 Nga analiza financiare, Komisionit i ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk mbulojnë shpenzimet me burime të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës për një diferencë negative prej - 370.165 lekë²⁷, për vitet 2012 dhe 2015. Lidhur me këtë konstatim, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për diferencën e vitit 2012, si dhe i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit për diferencën e konstatuar në vitin 2015.

27.3 Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e saj ndaj rezultateve të hetimit, lidhur me diferencat e konstatuara, ka pretenduar se për sa i përket diferencës së konstatuar në vitin 2012, duhen rishikuar zërat e shpenzimeve të jetesës, si dhe nisur nga fakti që viti 2011 ka rezultuar me diferencë pozitive, këto të ardhura kanë shërbyer për mbulimin e shpenzimeve të vitit pasardhës 2012. Për sa i përket diferencës së konstatuar në vitin 2015, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se vlera e shpenzimeve familjare, e vendosur në analizën financiare të vitit 2015, ka rezervë dhe nevojë për rishikim.

27.4 Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se: [...] *Shpjegimet e subjektit mbeten në nivel deklarativ, të pabazuara në prova*²⁸...*Pasaktësitë në deklarim dhe balanca negative e fondeve nuk janë të mjaftueshme që të sjellin aplikimin e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016. Për më tepër, Komisioni, gjatë hetimit administrativ, konstatoi se, në asnjë rast, pasaktësitë e konstatuara nuk kanë ndikuar në cenimin e burimit të krijimit të pasurive të subjektit të rivlerësimit*²⁹ [...].

28. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, analiza financiare, e kryer nga ana e Komisionit edhe në këtë rast, nuk është e plotë dhe nuk është hetuar për të gjithë elementet e saj.

28.1 Komisioneri Publik vlerëson se, përveç sa është konstatuar nga Komisioni mbi pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, për mbulimin e shpenzimeve dhe kursimeve në llogaritë bankare në vitin 2012 dhe 2015, nga vlerësimi i të dhënave rezulton se në gjendjen që janë aktet, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk mbulojnë me burime të ligjshme shpenzimet edhe për vitet 2014 dhe 2016. Në zërin e shpenzimeve të kësaj analize financiare do të duhej të gjenin pasqyrim, po ashtu, edhe ato shpenzime që lidhen me shpenzimet e kryera për udhëtime sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në pyetësorët përkatës dhe të dhënat e sistemit TIMS.

28.2 Nisur nga kjo gjendje që janë aktet e dosjes përkatëse, pas përfundimit të hetimit dhe dhënies së vendimit nga ana e Komisionit, Komisioneri Publik konstaton të nevojshme kryerjen e një hetimi të plotë nga ana e Kolegjit me qëllim: (i) rishikimin e metodologjisë së kryerjes së analizës financiare për personat e cilësuar si “persona të tjerë të lidhur” me subjektin e rivlerësimit; (ii) në varësi të rezultateve, kryerjen e analizës financiare për subjektin e rivlerësimit për periudhën e deklarimit.

III. Kërkimi i ankimit

29. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5, të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa ka disponuar Komisioni, referuar gjendjes së fakteve dhe

²⁷ Respektivisht, në vlerën negative 341.577 lekë në vitin 2012 dhe në vlerën negative 28.588 lekë në vitin 2015.

²⁸ F. 41 e vendimit të Komisionit.

²⁹ F. 50 e vendimit të Komisionit.

provave në rastin konkret, Komisioneri Publik nuk vlerëson se subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë;

30. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

31. Bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, DH, E dhe F të aneksit të Kushtetutës, nenit 4, 30-34, 40-44, pikës 3, 4 dhe 5 të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016;

32. Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit, të çelë hetimin gjyqësor dhe, bazuar në provat e marra në përfundim të gjykimit, në zbatim të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë në mënyrë alternative:

- Ndryshimin e vendimit nr. 264, datë 17.6.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit,

ose

- Lënien në fuqi të këtij vendimi.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA